



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12,14 dhe 17 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 shkronja (h), 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 01. 12. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoj këtë:

**VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E KOPSHTIT PËR
FËMIJËT PARASHKOLLOR NË LIPJAN**

Neni 1

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e kopshtit për fëmijët parashkollor në Lipjannë parcelën kadastrale P-71409044-01788-0 në vendin e quajtur "Varosh" me sipërfaqe prej 2590 m², të evidentuar në Certifikatën Nr.5457/2016 ZK Lipjan P.Sh Qerdhja e Fëmijëve.

Neni 2

Kushtet urbanistike-teknike si pjesë e procesit të procedurës së implementimit të projektit që parashihen me rregullativën ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit do të definojnë në harmoni me Projektin Ideor të prezentuar, planet urbane për këtë zonë dhe kushteve ekzistuese në parcelë, me qëllim të krijimit të zonës si tërësi urbane dhe funksionale për këtë qëllim.

Neni 3

Të gjitha procedurat që rrjedhin nga procesi i lejes ndërtimore që rezultojnë në përmbushjen e kushteve për kompletimin e dokumentacionit teknik si dhe taksat administrative janë obligim i komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati i Arsimit.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës për ndërtimin e qerdhës së fëmijëve parashkollor multietnik në Lipjan 15Nr.610-24897 i datë 30.06.2014.

15Nr. 464-66384
Lipjan, me 02. 12. 2016

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

**KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani - Hajnuni**

